



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E BREGDETIT**

Nr. 2789 / Prot.
1

Tiranë më, 09.08 2025

URDHËR
Nr. 136, Datë 09.08 2025

“PËR TARIFAT PËR DHËNIEN E INFORMACIONIT TË KËRKUAR”

Në zbatim të nenit 13, të Ligjit Nr. 119/2014 Për të drejtën e informimit (të ndryshuar me ligjin Nr. 78/ 2023, datë 21.9.2023), të Ligjit 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, të VKM-së Nr.569, datë 17.07.2019 “Për miratimin e kompetencave, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit” i ndryshuar, si dhe në vijim të Relacionit Nr. 2789, datë 24.07.2025,

URDHËROJ:

1. Tarifat e shërbimit të dhënies së informacionit, fotokopje/printim/CD, të jenë si më poshtë:

a) deri në 10 (dhjetë) fletë informacioni format A4, A3, fotokopje/printime bardh e zi/me ngjyra, përfitohet pa pagesë;

b) mbi 10 (dhjetë) fletë për formatin A4, fotokopje/printime bardh e zi/me ngjyra pagesa do të jetë **15 (pesëmbëdhjetë) lekë/fletë**;

c) mbi 10 (dhjetë) fletë për formatin A3, fotokopje/ printime bardh e zi/me ngjyra pagesa do të jetë **32 (tridhjetëdy) lekë/fletë**;

ç) për informacionin e dhënë me CD, pagesa do të jetë **70 (shtatëdhjetë) lekë/CD**.

2. Specialisti përkatës i sektorit të financës, në bashkëpunim me Koordinatorin për të Drejtën e Informimit të institucionit, të përllogarisë kostot totale të informacionit të kërkuar, duke ia vënë në dispozicion edhe kërkuesit/subjektit të interesuar.

3. Me pagesën e tarifës përkatëse nga kërkuesi/subjekti i interesuar, sipas faturës së arkëtimit, në llogari të institucionit dhe paraqitjen e mandatit bankar, kërkuesit/subjektit të interesuar i dërgohet informacioni në rrugë postare, ose mund ta tërheqë atë dorazi.

4. Përfshihen nga tarifat e përcaktuara në pikën 1, qytetarët e regjistruar rregullisht në skemat e ndihmës shoqërore, si dhe subjektet përfituese, sipas ligjit nr. 111/2017, "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti"

5. Ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe Koordinatori për të Drejtën e Informimit, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhëri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

